

Ramiz Harxhi

vjersha

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-1
H27



ndjenjat e zemrës

854-
H27

3

RAMIZ HARXHI

NDJENJAT E ZEMRES

(Viersha)

Zgjedhur dhe redaktuar nga

Andrea Varfi

KAFKORIT

GRUPOROKASTER

~~58227~~

12-618

SHTËPIA BOTUESË «NAIM FRASHËRI»



RAMIZ H
ARXHI

PARATHËNJË

«Patriot dhe poet popullor. Me vargjet e tij patriotike, që i shkroi kryesisht në organet e kolonive shqiptare të Amerikës, nxiti popullin shqiptar të ruajë mëmëdhenë nga armiqtë e jashtëm. Me satirën e tij demaskoi klikën sunduese reaksionare dhe anti-popullore të Zogut».

Me këtë motivacion Presidiumi i Kuvendit Popullor e dekoronte me medaljen «Për veprimtari patriotike» Ramiz Harxhin si një nga pasardhësit e Rilindasve tanë të mëdhenj ato ditë kur Gjirokastra e niste atë si delegat në Vlorë me rastin e 50 vjetorit të shpalljes së pavarësisë.

Ato ditë në Vlorë, Ramiz Harxhi mend fluturonte nga gëzimi. Fliste me emocion. Sytë i mbusheshin me lot mallëngjimi. Ishte në kulm të lumturisë: — E ndjej veten krejt të përtëritur, të rilindur! Jetova aqë sa ta shoh Shqipërinë zonjë të vetvetes, të fortë, të bukur e plot shëndet. Tashti, edhe po t'ju le, do t'i mbyll sytë i qetë dhe i kënaqur.

Admirimin më të madh Ramiz Harxhi e kishte

për Partinë, për luftëtarët e Çlirimit, për lirinë. Ai mbante në portofol edhe një fotografi, në të cilën shoku Enver përshëndetej përzemërsisht me të në qershorin e vitit 1959. — «E mbaj gjithnjë me vete» u thoshte shokëve e miqve duke ua treguar. Më nderoi në mes të popullit të Gjirokastrës. U mallëngjeva kur më recitoi edhe ca nga vargjet e vjershës sime «Druvari plak». E kemi xhevahir të rrallë! Të na rrojë e ta kemi gjithnjë me shëndet! Ai me shokë i duhet Shqipërisë dhe popullit, që të bëjmë mbroth me hapa vigane. Asnjë, nga ne pleqtë, kurrë nuk mund të mejtonte që, në dhjetë vjet, të përparonte vendi më tepër se në njëqind vjet. —

Po ta pyesje për vjershat e tij, të përgjigjej: — Jam duke i mbledhur. Pjesën më të madhe të tyre, në mos të gjitha, i mbaj mend. Kur t'i mbaroj, po i dërgoj në Tiranë. Ato që do të duken se vlejné akoma diçka për popullin dhe rininë, kam dëshirë të më botohen në një vëllim.

Po shkuan edhe disa vjet të tjerë që të përfundonte mbledhja e vjershave të përndara nëpër *shtypin e së kaluarës* (kryesisht të periudhës 1915-1935), *mjaft prej të cilave në shtypin e shqiptarëve t'Amerikës. Kështu, vetëm pas vdekjes së poetit u përgatit për shtyp* *lejo përmbledhje me vjershat e tij të zgjedhura.*

Brezi ynë, që rininë e mbylli me Çlirimin e At-dheut, ka patur si ushqim shpirtëror, krahas veprave

të rilindasve tanë të mëdhenj, Naimit dhe Çajupit me shokë, edhe një sërë veprash të tjera shkrimtarësh patriotë, nxënës së rilindasve, si ato të Ramiz Harxhit. Shumë prej tyre, veçanërisht ato me karakter patriotik, ne edhe sot i mbajmë mend fare mirë.

Prej Ramizit unë ruaj edhe një kujtim personal, që mendoj se vlen të rikujtohet, pasi hedh dritë mbi figurën e poetit patriot. Në verën e vitit 1932, kur kisha kryer shkollën tregëtare të Vlorës, u takova me poetin në një nga zyrat e Nënprefekturës së Himarës, ku ai punonte si sekretar. Biseduam gjatë për çështje të poezisë, për çështje patriotike dhe më në fund, për të provuar se, ashtu si mejtonte rinia, mejtonin edhe shumë patriotë të moshuar, ai nxori nga xhepi vjershën e tij «Kushtrimi kombëtar», një vjershë haptazi antizogiste, dhe ma lexoi. Pasi e mbaroi, shtoi me hidhërim: — Mos harro se atë qenin Zog, për ca kohë, pas Kongresit të Lushnjës, edhe unë, si mjaft të tjerë, e pata përshëndetur si «trim me shpatë» në shërbim të Atdheut. Sa dritëshkurtër patëm qenë, që besuam se nga oxhakët e bejlerëve esadistë mund të dilnin «shpëtimtarë të kombit»! —

Ky qëndrim i Ramiz Harxhit kuptohet fare mirë, veçanërisht prej atyre që kanë jetuar atë kohë. I rritur në atmosferën e përpjekjeve dhe të luftërave për liri, i frymëzuar me romantikën e patriotëve të Rilindjes e gëzimin e shpalljes së Pavarësisë, i prekur thellë nga dhëmbja e rëndë e pushtimit t'Atdheut,

nga tragjedia e vëllezërvë dhe motrave tona masakruar nga bandat e shovenistëve grekë e serbë, nga «tmerret e Hormovës», nga kalvari i «Ullinjve të Vlorës», ku gjetën vdekjen mijëra muhaxhirë, nga thika e tradhëtisë bejlero-esadisto-andarte, i frymëzuar nga epopeja e Vlorës dhe e brigjeve të Drinit, i revoltuar nga zgjedha feudo-borgjezo-fashiste e Zogut, Ramiz Harxhi, edhe në ato kushte të rënda, nuk i tradhëtoi idealet e rinisë së tij. Përkundër ai u bëri jehonë atyre ngjarjeve, atyre pak gëzimeve dhe shumë dhëmbjeve kombëtare e shoqërore të kohës, qëndroi armik i tradhëtarëve dhe i padrejtësive, i obskurantizmit dhe i hipokrizive, mik i përparimit dhe i emancipimit të gruas shqipëtare, përkrahës i zjarrtë i rinisë.

Ramiz Harxhi jetoi gjersa mbylli sytë, si një urë bashkimi në mes të traditave më të mira të Rilindjes kombëtare të parë me Rilindjen kombëtare të dytë dhe të vërtetë, dielli i së cilës shkëlqeu për të mos perënduar kurrë në Nëndorin e madh të vitit 1944.

Duke folur për Rilindjen e dytë, Ramizi kurdoherë sillte ndër mend edhe Rilindjen e parë. Edhe pas pesëdhjetë vjetësh, këtij i mbusheshin sytë me lot gëzimi, kur kujtonte atë çast të lumtur, kur mori vesh ngritjen e flamurit në Vlorë. — Atëhere isha student në një gjimnaz të Stambollit, na thoshte në janarin e vitit 1962. Kur muarëm vesh shpalljen e pavarësisë, unë dhe pesë shokë të tjerë kënduam

marrëzisht tërë një natë, brohoritëm sa u ngjirëm. Në mëngjez u arrestuam nga policia turke. Do ta kishim pësuar shumë keq, pasi gjendja ishte shumë kritike për turqit, për shkak të disfatave që pësonin në frontet e Luftës ballkanike. Po, lumtërisht për ne, në policinë e asaj lagjeje u ndodh një shqiptar nga Kosova, i cili na liroi.

Me largimin e flotës greke nga Dardanelet, Ramizi u kthye në Gjirokastrë. Po vendin e gjeti të pushtuar nga ordhitë e Athinës, që ua kalonin në poshtërsi dhe krimë edhe atyre të Turgut Pashës me shokë. Kjo gjendje e dëshpëroi edhe më tepër dhe, një natë të errët, plot me shi, tok me tre shokë, le Gjirokastrën, i ngjitet Malit të Gjerë, zbret në Grykën e Skërficës, kapërçen Fushëbardhën e Zhulatin dhe ngjitet në Majë të Pusit, ku arrin forcat shqiptare në komandë të Çerçiz Topullit. Atje qëndron gjersa Çerçizi me forcat e tij hidhet në malin e Taroninës dhe Ramizin e këshillon që të hidhet pak më tej, pranë Kolonjës, në rreshta të tjera shqiptare, të udhëhequra nga patrioti tjetër luftëtarë, Hasan Xhiku, po nga Gjirokastra. Atje takohet edhe me shokun e vjetër të shkollës, Avni Rustemin. Pas përleshjesh me forcat shoveniste greke, fuqitë tona detyrohen të marrin drejtimin e Vlorës, për ta mbrojtur nga kërcënimi esadist. Ramizi, i dobësuar shumë nga jeta e malit, zbret në Vlorë dhe, në praktikë të hyrjes së esadistëve në qytet, merr udhën e mër-

gimit. Shtatori i vitit 1914 e gjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Atje, në mes të bashkatdhetarëve, me brengën e Shqipërisë në zemër, shkruan shumicën e vjershave të tij, hap shkolla nate për të luftuar analfabetizmin. Është në krye të shoqërive patriotike; boton vjersha dhe artikuj.

Pas gjashtë vjetësh mërgimi, në tetor të vitit 1920 u kthye n'atdhe, ku u muar me nëpunësi të ndryshme dhe vazhdoi të shkruajë vjersha.

Mbylli sytë në Gjirokastrë më 11 nëndor 1966 në moshën 74-vjeçare.

Nga gjithë krijimtaria e Ramiz Harxhit, pjesa më e mirë sot po botohet në këtë vëllim.

Si do të shihet nga vetë lexuesit, krijimtaria e Ramiz Harxhit karakterizohet nga një tematikë e shëndoshë, e diktuar nga vetë kërkesat e kohës kur jetoi poeti.

Si poet Ramiz Harxhi është kryesisht vazhdues i poezisë sonë të Rilindjes; pra, tema patriotike ze vendin kryesor në vjershat e tij dhe përshkohet nga nota romantike e kohës. Duke pasqyruar ngjarje që rrezikuan shpesh pavarësinë e fituar dhe gjendjen e rëndë të vendit e të popullit, shpesh këto vjersha përshkohen nga protesta kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe nga një notë keqardhjeje e pikëllimi për popullin. Por veç temës patriotike, të përbashkët me rilindasit, në vjershat e tij hasim

edhe tema me karakter shoqëror, ku zotërojnë tonet satirike kundër forcave reaksionare, kundër zakoneve prapanike, kundër obskurantizmit fetar. Këto motive e bëjnë prodhimin poetik të Ramiz Harxhit edhe më të afërtë me poezinë tonë të re.

ANDREA VARFI

SA TË DUA

O shqipëri, o vëndi im i ndritur,
Dhe pse larg teje unë kam ikur,
Larg teje ikur, larg teje sjellë,
Ty të kam dashur sa shpirtin thellë!

Ty të kam dashur, se mëma ime
Për ty më bënte aq ligjëtime;
Oh!... erdhi dita që të gëzohem,
Me jetën tënde të frymëzohem!...

Oh, sa i dashur dhe sa i ëmbël
Qenke ndaj meje, o vënd pa shembëll!
Oh, sa i dhëmshur qenke për mua;
Oh, sa të dua!... oh, sa të dua!

Im atë thoshtë se ti je zonjë
Dhe ke në flamur ti një shqiponjë,
Unë nga zemra, nga vetëdia
Thrrisja përhera: «Ri oftë Shqipria!»

NE UDHE TE MERGIMIT

Det dhe det, si fush'e gjërë,
Që s'ka të sosur një herë!
Udhëtoj, po zemra ime
M'është bërë thrime-thrime.
Mejtimet po më pushtojnë,
Dhe mendjen ma trubullojnë:
Mejtoj Atdhen'e vërtetë,
Kombin e gjor'e të shkretë;
Mejtoj ç'ngjarje do të dalë
Për të mjerët shqipëtarë:
A mund ta kenë lirinë,
Shqipërin'e qetësinë?
Mejtoj mëmën e vëllanë,
Mejtoj të ndjerin, babanë;
Mejtoj shokët edhe fqinjët,
Kushërirat, kushërinjtë,
Ata në zjarr e në thikë:
Unë po shkoj n'Amerikë!

1914

TMERRI I HORMOVËS

Ç'më pësoi kjo dora që më dridhet shumë,
Ç'kanë lott'e syve që derdhen si lumë?
Ç'më pat vallë mendja që m'u turbullua,
Pse derdh gjak zemra si rrëke e prrua?
Po pendën ç'e gjeti që s'ecën siç duhet,
S'shkruan si çdo herë, po qëndron e ndruhet?
Ku e ndjejtë vallë se ku do ta shpie,
E në ç'katastrofë këtë do ta shtije?...
Ecë, pendë, ecë!... Ç'dridhte si purtekë?
Qepju asaj kodrës, lart mbi atë breginë,
Shiko ato male, brigje historie,
Ku aq therje u bënë, therje barbarie...
Atje do të dalë një tablo e shkretë,
Një tablo e tmerrshme, që s'u pa në jetë!
Kjo tablo stoliset me gjak të shqiptarit,
Edhe po qindiset nga dor'e barbarit!...
Hormovitë e mjerë togje-togje mblidhen,
Lart nga dyqind veta n'ato vise sillen,
Pleq e çiliminj e burra sa qenë,
Me frikë e të dredhur si në shtrungë venë.

Deshnë a s'deshnë, u falë e i dhanë besë,
Asaj Greqi shtrigës, kurvës së pabesë;
Dhe kush ishte fshehur në prrenj a në ferra,
Kërkohej e zirej e shpiej si shqerra.
Shpien njerzt' e gjorë, të pafajshmit kurrë.
Të theren si berat, të shtypen me gurë,
Të shpohen me thika, në brinjë e në ballë,
Pa mos mbet' prej syresh as dhe një i gjallë! . . .
Bobo, kjo mynxyrë, kjo mëkatë e madhe,
Që na gjeti neve, përmbi gjith' sa halle,
Përmbi gjith' mjerimet, mbi gjith' ligësirat,
Mbi gjith' ngatërrimet, zjarret e mynxyrat! . . .
S'mjaftoi ç'psherëtimë e ç'lotë që derdhmë,
S'mjaftoi ajo gjëmë q'u grim' e u thermë,
S'mjaftoi Shqipëria q'u dogj, u shkretua,
S'mjaftoi që ky shtet gjithë u rrëzua,
S'mjaftoi ky sterrim, kjo e madhe flagë,
Po na dhe Hormova një plagë mbi plagë! . . .
O moj Kodr' e zezë, Kodra e munxuar,
Kodra mynxyrjare, plakë e shëmtuar,
Gjith' ato që pe, e gjith' ato që ndjeve,
Vallë kujt ja the e kujt ja rrëfeve?
Si t'u ndënj e shihje gjith' ata barbarë,
Që thernin e vrisnin aqë shqipëtarë?
Si s'u tunde vendit e s'u revoltove,
Gjith' ata gjakpirës si nuk i largove? . . .

1915

BEHARI DHE ZEMRA IME

Dimri ikën, vera vjen,
Bari mbin e gjelbëron,
Bora shkrin, dielli shkëlqen,
Po kjo zemër as ndryshon.

Shpezët çelen, fluturojnë,
Njerzit gjithë në gzim,
Lozin, qeshin, lumturojnë,
Po un' prap jam në rënkim.

Yjtë ndrijn'e xixëllojnë,
Dhe bilbili po ja thotë,
Djem e vasha dashurojnë,
Unë rri e qaj me lotë.

Kur beharet ven' e vijnë,
Gjith' natyra buzëqesh,
Qielli ndrin e vetëtin,
Po veç unë s'mund të qesh.

126/18

5-2227

17
BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJEROKASTER

Ah, për mua s'ka gëzim,
Dhe kështu, pra, do rënkoj,
As behar s'ka, as dëfrim,
Vendi im po s'lulëzoi!...

1916

SHQIPËRISË

O moj Shqipëriz' e mjerë,
Zonjëza me famë!
Ç'i bëre burrat e ndjerë,
Që ta shtonin namnë?!...
Ç'është kjo mynxyr' e keqe
Që po të ngjet ty?
Qysh u vure ti në leqe,
O vëndi fatzi?!
Një kohë gjith' njerëzia
T'ishin plot gëzim,
Tash edhe foshnjëria
Janë më rënkim.
Një rrufe të ka goditur,
Një zjarr më çdo anë,
Me gjak trimi je vaditur,
Skuqur anembanë!...
T'u arratisnë fëmia,
Çiliminj e gra;
T'u gri gjithë burrëria,
T'u ther e t'u vra.

U godite, u plagose
Më çdo anë e kënd,
Me gjak biri, u lumose,
Pellg t'u bë çdo vend.
Sot ti mbete baltë e gurë,
E mjërë mbi dhe;
Mbete si grua pa burrë,
Fatzez' edhe e ve.
Sot për sot je e dënuar
Të qash, të vajtosh;
Po ngreu, o e bekuar,
Shpëtim të kërkosh!...

1916

MËRGIMI

Nevoja e bën njerinë edhe varfëria,
Të largohet e të ndahet nga familj'e tia.
Hall' i fortë njerëzinë e shtyn të mërgohet,
Të shkojë gjer prapa diellit e të dëshpërohet.
Kush e lë Atdhen' e vet pa shkak e pa ngutje?
Kush pëlqen ta shkojë jetën me ah e me lutje?
Dashurin' e vatrës tija njeriu e ka çmuar,
Duk'u ndarë nga gjir'i saj e duk'u larguar.
S'është lehtë të lësh mëmën, gruan e shtëpinë
E të shkosh ku s'ta pret mendja, të marrsh arratinë.
Në ka njeri te kjo botë që vdes nga kahari,
Pa dyshim ne do të themi: «vetëm mërgimtari!»
Kur kujton njeriu i mjerë vendin ku ka lerë,
Psherëtin dhe jeta e gjithë i duket skëterrë.
Në mërgim njeriu i gjorë dhe në dëfren pakë,
Me kujtimin e Atdheut mbushet vrer e flakë.
Mërgimtari te kjo botë është dëshmor i gjallë,
I dënuar për brengime, i vrarë në ballë.
Gjith «ah-e» edhe «vah-e» kush është në botë?
Mos ja lyp veç mërgimtarit atë të ta thotë!

Mërgimtari mund ta dijë sa orë zgjat nata,
Mërgimtari i di muajt me ditë e me data,
Në çdo çast sa është ora ai mund ta dijë,
Se ai nxjerr aqë ahe për mëmë e fëmijë,
Me një fjalë, për njerinë, m'e tmerrshme në jetë,
Është ikja nga vendlindja si mjerosh i shkretë!

1917

NDËJESAT

Kur papët një kohë donin të dëfrenin,
Lëshonin agentë botën ta gënjenin.
Në çdo vend përhapnin njerëz me ndëjesa,
Që të ripnin botën, t'i mbanin me shpresa,
Se ish njerëzia në t'errët, në gjumë.
Papët aso kohe kishin forcë shumë,
Bënin si të donin dhe, me dhelpërira,
Porsi magjistarët, shisnin profetira.
Populli i gJORë, jo se s'i kuptonte,
Po të shante papën asnjëri s'guxonte;
Kush që hapte gojën kundër atij fronti,
Shpejt e hidh në flakë inkuizicioni.
Ai ish një shtazë, murtaj'e skëterrë,
Dhe s'mundej të fliste njerëzi e mjerë.
Kështu me mosdashje papa adhurohej,
Gjersa u çel drita që krejt të përçmohej.
Një nga ata papë urdhëron një ditë,
Dhe e thurret përpara prift Teçel banditnë;
Për një shumë lira kishte mjaft nevojë,
Prandaj thirri priftin q'atë ta mësojë,

Të japë ndëjesa edhe të baresë,
Posht'e lart të vejë që ato t'i shesë,
Të dij si të sillet, ç'gënjeshtër të thotë,
Ja mësoi të gjitha si të rip në botë,
Kështu dhe Teçeli, prifti i pabesë,
I mori ndëjesat q'ishin si dëftesë,
Dëftes'e shënuar për njerz mëkatarë,
Si për fajtorë, si për gjakatarë.
Këtë kush e blinte nga çdo gjë shpëtonte,
Zoti gjith' mëkatet atij ja shkarkonte,
Dhe kë jip më shumë, papa do ta ftonte.
Kyçet e parajsës të ja dorëzonte. . .
Me të tilla lajka djall'i perëndisë
I binte më qafë gjithë varfërisë.
I korri sa munda, ropi më çdo anë,
Sa q'e bëri papën të fiton dynjanë.
Po kundër së ligës, kundër poshtërsisë,
Sa vete po shfaqet yll'i drejtësisë,
Sa vete njeriu zë të kupëtojë,
Shenjtëri e profka të mos i besojë.
Zë të ket' guximin, të dij' ta përdorë
Drurin e parajsës mbi njerzit mizorë,
Si na e përdori një fshatar një natë,
Duke na e shëmbur prift Teçel lugatnë.
Njerën nga ndëjesat pasi ai ja bleu,
Me një dru kandari mes për mes e theu!
Kështu kundër djallit, priftit të harbuar,
Del usta mbi gjithë ky fshatar i zgjuar!

DRUVARI PLAK DHE VDEKJA

Një herë niset për dru një plak,
Mbledh një tok shkarpa, i bën vandak
Vapa ish vapë, sa s'thuhet dot,
I kulloi plakut djersa si lot.
S'kish, veç kurrizit, kal' a gomar,
Asgjë s'i ndodhej, as ndihmëtar.
Ishte i thinjur, s'kishte fuqi,
Ishte në botë lum' e fatzi.
Ishte i varfër, pa gjë, pa mall,
Pa kishte mbetur keq e në hall.
Me dru në krahë vin' në fole,
Her' ecë e herë unej në dhe;
Ngarkesën gjithë përmbi kurriz,
Në djersë i mbytur i vin shtëpis'.
Eci sa eci pastaj qëndroi,
Barrën e rëndë prap' e shkarkoi,
Dhe zu t'mallkojë jetën e shkretë,
Thosh: — Plak si unë, asnjë mos mbettë.
Jeton njeriu, të ketë nder,
Dhe jo t'i duket jeta si ferr!

Oh, ç'm'u lodh mesi, i gjori u',
Ç'm'u desh të mjerit barra me dru!
Më kulloi djersa, gjaku m'kulloi,
Prap' këtë barrë më s'e ngarkoj!...
Ç'më duhet rrojtja? Më mir' në baltë.
Baltë për mua është si mjaltë! —
Vdekjen e shkretë po thret me zë:
— O vdekje eja, eja ku je!
Merrmë t'i shpirtin e mos më le! —
I gjori fjalën kur e mbaroi,
Vdekja iu qas e pran' i shkoi:
— Ç'më do, or burrë, pse më kërkon?
Se ke kaq kohë që ligjëron,
Jetën s'e dashke, vdekjen lëvdon,
Edhe në baltë kërkon të hysh!
Ashtu u bëftë, unë s'ta prish!...
Habitet plaku edhe rënkon:
— Un'a?!... unë, s'të dua gjë,
Po hidhma pakëz në sup këtë.
Nuk ngre dot barrën se s'kam fuqi,
Prandaj të thirra të ma ngresh ti. —

PËR THEMISTOKLI GËRMENJIN

(Elegji)

U tund vendi dhe Ballkani,
Qani shokë, me lot qani,
Qani gjithë trimërinë,
Trimn' e madh, Themistoklinë.

Qani burrin e lëvduar,
Patriotin fort të çmuar,
Që u vra, na la dhe shkojti,
Që për jetë na shkretojti.

Qani ju, o patriotë!
Derdhni zemrat, derdhni lottë;
S'kemi fat ne për gëzime,
«Jemi lindur» për hidhrime.

Kur zë ylli të ndritojë,
Kur zë zemra të shpresojë,
Një shigjetë na vërvitet,
Shpres'e mendje na tronditet.

Sikur s'ishin mjaft sa vuam,
Sa u dogjm'e sa u shuam,
Ç'është' për kombin gjith' kjo nëmë,
Të gëlltitij mijra gjëmë?

Qani shpella, male, gurë,
Pleq e plaka e çdo burrë;
Kodra, fusha, mos pushoni,
Po përherë ju vajtoni.

Qaj, moj Korçë, plot me plagë,
Shkrep nga sytë zjarr e flagë,
Qaj për trimin përmbi trima,
Që të ish si vetëtima!

Gjith' sa lindnë kanë vdekur,
Po lum kush është përpkur;
I pavdekur është' për jetë,
Kush mbaron për kombn' e vetë.

1917

SHKOLLA «DRITA» E GJIROKASTRËS

Erdhi dita, shkolla «Drita»
Të na çelet përsëri!
Lum qyteti, lum ne gjithë,
Lumja mëmë Shqipëri!

Pas aq vjetësh errësirë,
Varfërie e mjerim,
Drit'e shenjtë zbardhëllojti,
Shkrepi dielli me shkëlqim

Oh, kjo ditë, sa me dritë,
Sa me shumë dashuri,
Erdh për ne që të na sjellë,
Në të ardhmen lumturi! . . .

Shkolla «Drita» do na ndritë,
Anemban' e më çdo kënd,
Lavdi paçin, në çdo anë,
Nisiatorët aq me mend.

Lum si ju shpresa të arta,
Lum si ju, o vegjëli,
Kur të çohi, do të duki,
Lule gjith' për Shqipëri!

Rrofsh përdita, shkolla «Drita»,
Rrofsh, o djep i diturisë;
Do të jesh për vendin tonë,
Dritëz' e vëllazërisë! . . .

1917

QIME E BARDHË

Qim'e bardhë ç'më ka dalë,
Që tani kur un jam djalë,
Mbiu shënja e pleqërisë,
Te kjo mosh'e djalërisë.

Qim'e bardhë seç më dolli,
Këtë mjergull ç'erë e solli?
Kur u mplaka menjëhera,
Në njëzet e ca pranvera?!...

Qim' e bardhë, shenj' e zisë,
S'është' tregim i pleqërisë,
Po pasqyrë e jetës sime,
Plot me brenga e hidhërime.

Kur gjith' bota lulëzonte,
Zemra ime krejt lëngonte,
Prandaj krisi përmbi ballë,
Për çdo ah një qim'e bardhë.

Do të jepte historitë përmbi gjithë sa ka parë,
Trimërit'e theroritë të stërgjyshvet shqipëtarë.
Dhe shtëpitë po prej guri, me ca mure si fortesa,
Prapë prej guri pullazet, gur e plloça për mbulesa.
Çdo banesë larg e afra, një mbi tjetrën grumbulluar,
Veç me pak oborr a kopshtë është ndarë e kufizuar.
Gur godinat, gur çdo anë, fund e krejt me gur qyteti,
Kur bën vapë, s'ka as ujë, pa mundohet gjith rrëmeti.
Ujë s'kemi, mjete s'kemi, pra do thoni qysh jetojmë?
Ja të vetmen arësye me pak fjalë ta tregojmë:
Ujë s'kemi, asgjë s'kemi, po durojmë, rojme er'ë rrimë,
Se qyteti ku ne lindëm, ka të pastër er'ë klimë:
Syt'e tij i ka nga lindja, nga ku dielli shkrep n'agime,
Stoikisht e mban rrëmetin, ndonëse me ca mundime.
Ja qysh është Gjirokastra, qepur brigjesh një rrëpinë,
Vend'i dhëmshur ku kam lerë, ku kam fisin e
shtëpinë.

1918

LUFTA E LABËVE NË GRYKËN E SKËRFICËS

1914

S'mbaj mënd ç'datë ishte, veç di sa ish moti,
Dhe di se kush doli më trim e m'i zoti,
Në luftën e rreptë, q'u bë në Skërficë,
Ku, kundër një tufe, luftoi një pakicë.
Gryka e Skërficës, një grykë e keqe,
Mbrohej prej ca burrash pa armë e fysheqe.
Luftonin shqiptarët me qindra barbarë,
Me ushtarët grekë, veshur si andarë.
Grykën e Skërficës, shtegn'e Labërisë,
Ç'e kishin rrethuar shtazët e Greqisë.
Mitrалozat ngulur, topa anembanë,
Të shkulin nga vendi ndo dyzet luanë.
Erdhn'e na rrethuan, për paqe na ftuan,
Dhe Grykën e rreptë pa luft'e kërkuan!
Po lab'i Atdheut, që përpinte retë,
S'mund ta jepte vendin, pa vdekur dhe vetë!
Kështu u ndez lufta, me tërbim sa munda,
Sa shkëmbinj e gurë nga vendi i tundi.

E kish sjellë hera, sedra, vetëdia,
 Të ndodhsha dhe unë tej te Labëria,
 Të rrija në gjunjë edhe të shikoja,
 Trimërin'e labit atje ta dëshmoja.
 Togu që përbëhej këtej Labërisë,
 Ishte shumë m'i pakë nga i mizërisë;
 Një shqiptar pothuaj luftonte për pesë,
 Se ishin të tepër grekët e pabesë.
 Po ku trëmben trimat sepse jan' të pakë,
 Ata shkrepëtijnë si rrufe dhe flakë.
 Për zjarr bij' boria dhe buçiste zjarri,
 Eh, t'ishe të shihje si lufton shqiptari,
 Si luftonte labi i pandrojtur kurrë,
 Me ca pak dyfeqe, dhe ato plot zgjurë! ¹⁾ . . .
 — Zjarr! — thërrit komanda dhe zjarr shumë herë
 U sulnë të gjithë si shkabat në erë.
 Plumb nga këjo anë, top nga ajo anë,
 U përleshnë shtazët me një grusht luanë.
 Bam bënin andartët, bum dhe shqipëtarët,
 — Yrysh! — së këtejmi thirrënë kordhëtarët,
 Dhe kamat e thikat nga brezat i qitnë,
 — Përpara, o shokë! — britn'e u vërvitnë.
 U tundnë nga vendi, sulmuan më këmbë,
 U derdhnë mbi qentë t'i shqepnin me dhëmbë.
 Trimërisht luftuan me rrëmbim sa s'thuhet,
 Sa q'ajo betejë as mund të përshkruhet.

1) Zgjyrë

Këtu grekë u grinë, u grinë e u korrë;
Po dhe trimat tanë dhanë ca dëshmorë:
Dëshmor Halil Sullon, Dalip Kondin burrë,
Kombi brez pas brezi nuk i harron kurrë.
Të pavdekur janë gjith' ata luanë,
Që për nder të kombit u grin'e u vranë.

1919

JETA IME NË AMERIKË

Gjashtë vjet po mbushen që rri i mërguar
Nga Atdhe, nga mëmë, nga ç'kam dëshëruar.
Gjashtë vjet të tëra, ah, jetë plot gjëmba:
Ku erdha i mjeri, ku më shkeli këmba! . . .
U thava, u treta e u rraskapita,
Në brenga, në vrere, në ankthe u mbyta.
S'paska, pra, për mua asnjëmend gëzime,
Më duket se linda vetëm për hidhrime.
Lashë nënën plakë në zi e në pikë
Dhe e solli fati të vij n'Amerikë.
Të vij te kjo botë, dhe krejt më të kotë,
Të vuaj, të dergjem, të derdh gjak e lotë. . .
Ç'fat të zi ke tinë, trupi im i mjerë,
Sos ti u krijove të vuash përherë?
Sos, pra, je dënuar të jesh i mërguar,
Nga Atdhe, nga mëmë, nga ç'kam dëshëruar?
Kur bota e tërë shijon lumtëria,
Ty të ran' në pjesë ditë kaq të nxira!
Nuk do kesh dhe tinë një jetë verore;
S'do shohsh Mëmëdhenë zonjë madhështore,

Nuk do lumtërohesh e të kesh lirinë,
Atje ku je lindur e ku ke shtëpinë?...
Ah, njeriu i gjurë se me ç'mendje mbahet.
Që s'thyhet si qelqi edhe nuk përndalet!
Ikën foshnjëria, ikën djalëria,
Prapë ai thotë se s'vjen pleqëria.
Mund dhe të përmbysesj kjo jet'e pabesë,
Po mos ish në zemrat një e shënjtë shpresë!
O e shënjta shpresë, ti je e bekuar,
Pa ç'ka sepse unë sot jam i mjeruar...

1920

LAMTUMIRË, AMERIKË!

Prej vjetësh mërgime,
Në zi, në trishtime,
Në helm e në pikë,
Sot me plotë dëshirë,
Të them lamtumirë,
Ty, moj Amerikë.

M'ish mërzitur shpirti,
Po fati më ndriti,
M'u bë shok me besë;
Shkoj, pra, dhe një herë,
Atje ku kam lerë,
Ku kam nder'e shpresë.

S'ka më gaz për mua,
Se sa ky që dua,
Të shkel baltën time.
Erdhi, pra, dhe ora
Të jap që nga Vlora,
Atdhe, ngjatjetime!

VAPORIT «PATRIA»

Shko, vapor, nxito si erë
Shko se mjaft jam i mërzitur,
Shpjermë mua, menjëherë,
Ku kam lerë e ku jam rritur.

Po më soset, pra, durimi,
Baltën time për ta parë,
Kaloj kulmin dëshpërimi,
Sytë mbushen për të qarë,

Shko, vapor, e mos qëndro,
Kij për mua pak mëshirë,
Shko me nxit dhe më shpëto,
Shpjerm' atje ku kam dëshirë.

Ecë, ecë porsi plumbi,
Çaje detin e pasosur,
Fluturo si zog pëllumbi,
Mos më mba, pra, të brengosur.

Shty, moj er'e shty, moj valë,
Se mjaft rrojta i mërguar,
Shty vaporin që të dalë,
Në Shqiprin'e ëndërruar!

1920

TRUMBETA E BASHKIMIT

Në duam Shqipërinë tash që ta nderojmë,
Në duam lirinë ne në këtë botë,
Në duam ta zhdukim mjergullën e zezë,
Duhet shpirtet, zemrat, forcat t'i bashkojmë,
Se kështu mundimi nuk na shkon më kot,
Edhe gjith' do t'jemi të lidhur me besë. . .

Çohuni, vëllezër, burra shqipëtarë!
Lidhuni me besë, mos u dëshpëroni,
Bashkoi, o trima, të lirë do t'jini,
Mjaft, pra, i duruam shkelësit barbarë,
Dhe, armët e shenjta plot zjarr i shtrëngoni,
Se gjithë vëllezërit krah për krah i kini! . . .

Sot zu të gjëmojë trumbet' e bashkimit,
Taborrët e nderit i fton që të mblidhen,

Vullkan' i pashuar, zjarr i atdheisë,
Nis të avullojë me gaz të shpëtimit,
Plot vrull e pa ndrojtje luanët të hidhen,
Për nderin e kombit, mëmë Shqipërisë!

1920

LUFTE PËR LIRI

Në këmb'u ngrit sot gjith' trimëria,
Evropës bushtër, fqinjit dinak
T'i presim hovin, sepse Shqipria
Mënt bëhet skllave, e hedhur në lak.

I kapnë armët plot gaz e shpresë
Për nder e liri të shejtit atdhe,
U lidhnë trimat të gjith me besë,
Me këngën «Vdekje a ngjallje për ne».

S'e njojt shqiptarin Evrop' e pabesë,
Prandaj shum' lehtë vendosi coptim,
Na diti të vdekur, të shtrijtur në shtresë,
Dhe s'diti se vdesim me zjarr e tërbim.

Mjaft vojtje dhe zgjedhë për kombin shqiptar!
Mjaft rrojtja e zezë, në t'errët, më kot!
Në këmbë, o shqiptarë!... Armikut barbar
I falin Shqiprinë, si tokë pa zot!...

Vërsuli, o burra! Se emr'i Skënderit
Do jetë me neve, në zemrat çdo ças,
Le t'jetë kjo fjalë parulla e nderit:
«Ja ngjallje përjetë, ja vdekje me gaz!»

Në luftë, në luftë, me këng' e hurra!
Në duhet të rrojmë me nam n'histori,
Të japim për kombin ne shpirtin si burra,
Të thuhet se vdiqëm për nder e liri!

1920

TË LUMTË, O GJAHTAR I KOMBIT!

— Avni Rustemit —

I guximshëm një gjahtor ç'e përmbysi tradhëtorë,
Ç'e përfshiu një kuçedër, oh, i lumtë ajo dorë!

Gëzim, gëzim, o shqiptarë, se shpëtojti njerëzia,
U qërua gjëmb' i helmët, thrrisni! «Rroftë
Shqipëria!»

U rrëzua Esat djalli, kriminel' i aq mjerimit,
U dërmua qen'i ndyrë prej një plumbi të një trimit.

Sot ky popull mori frymë prej studentit dorëartë.
U çlirua nga një ferrë, fitoi shpirt e u ngrit lartë.

Ky gjahtar i kombit tonë, për ne gjith' është një
kurorë.

Se me plumba e goditi, e përmbysi tradhëtorë.

O gjahtar, o i shkëlqyer, ty kjo tokë të ka rritur,
Për t'i dhënë kombit dorën, Shqipërinë për ta ngritur.

Ti je burrë shembëllor, i meritës për shtatujë,
Se e zhduke tradhëtorin, shkakëtarin për rrëmuje! . . .

1920

V L O R Ē S

Vlorë, jona Vlorë!
Ku je, moj e gJORë,
Kush të ndajti tinë,
Q'ë nxive Shqiprinë?

Ty, moj Vlor'e mjerë,
Që shpalle, njëherë,
Lirin'e Atdheut,
T'hero Skënderbeut,

Sot në lak të hodhnë,
Të ndajtën, të vodhnë;
Po shpresë një ditë,
Prapë të shohsh dritë!

Vlorë, Vlor'e zezë,
Kij durim e shpresë,
Se arrijti ora,
Të ja bëjmë fora!

Vlorë, Vlorë, Vlorë,
Shiko ç'kam në dorë:
Një pend' e një bombë,
Për të ngritur kombë,

Kështu Vlora jonë
Për ty gjithmonë,
Ne do të luftojmë,
Sa të të çlirojmë!

1920

PËR SELAM MUSA SALARINË

(Elegji)

Kush u vra nga Salaria?
Selam Musai petriti;
Ballë luftës ai ndriti,
Sa që mburret Shqipëria,

Ai ishte trim mbi trima,
Nuk i trembej syri kurrë,
Dhe vërsulej ky plak burrë,
Si t'ish vetë vetëtima.

Luftoi grekët aqë herë,
Edhe mori aqë plumba,
Ju bë trupi vrim'e xhumba,
Po s'pësoi gjë trim'i ndjerë.

Ku ja bënte bam dyfeku,
Selam Musa kordhëtari

Ish përmbi shokët i pari,
Dhe s'i vinte kot fisheku.

Dhe në luftën për në Vlorë,
Selami me aq' luanë,
Ç'ë përdrodi j'ataganë,
Më i lumtë ajo dorë!

O Selam, hero me fletë,
Që kudo e tunde dhenë,
Dhe u vrave për Atdhënë,
I pavdekur qofsh për jetë!

1920

Shqipëri, o mëma jonë,
Rro për jetë e lumtëro,
Ndrin, gëzo, shkëlqej gjithmonë,
Përparo dhe lulëzo!

SHQIPËRI, O MËMA JONË!

Shqipëri, o mëma jonë,
Rro për jetë e lumtëro,
Ndrin, gëzo, shkëlqej gjithmonë,
Përparo dhe lulëzo!

Shqipëri, o mëma jonë,
Rro për jetë e lumtëro,
Ndrin, gëzo, shkëlqej gjithmonë,
Përparo dhe lulëzo!

Ndrin, o djep i trimërisë,
Më çdo an'e pa pushim,
Zanë e bukur e lirisë,
Zgjohu, ngjallu me shpejtim!

Bijt'e tu, o mëm e shtrenjtë,
Gjith' të kanë në kujdes,
Gjithkush «rrofsh» thrret, o e shenjtë,
Që kur lind e gjersa vdes.

Adriatiku me valë,
Dhe gjith' kombi shqipëtar,
Sot për ty çdo vashë e djalë,
Ësht' theror e vullnetar.

Pas aq vjetësh robërie,
Vojtje, zie e mjerim,
Dolle sheshit, siç ke hije,
Si një zanë plot shkëlqim.

Dielli sot, në lind mbi jetë,
Lind dhe për ty, Shqipëri!
Ngrite krye, siç di vetë,
Pra, fitove nder, liri!

PENDËS

M'e mprehta shpatë, m'e mprehta lëndë,
Ti je në botë, e shënjta pendë,
Topi dhe pushka e gjith' sa janë,
Forcën që ke, kurrë s'e kanë,
Ti ke rrëfyer gjith' ç'kanë ngjarë,
Ç'trima kan' ikur e janë vvarë,
Gjith' historitë me ty u shkruan,
E mir' e liga me ty u shquan.
Zjarrin e shenjtë t'atdhetarisë,
Ja ndez më tepër gjith' njerëzisë...

1920

ÇUPËS SHQIPËTARE

Çup' e vogël, çap në shkollë,
Rroke shpejt ti diturinë,
Bëju, vashëz, mendjehollë,
Të japsh dritë për Shqiprinë,

Çup'e vogël shqipëtare,
Flak zakonet që pengojnë,
Bëju shpejt përparimtare,
Të shpëtojmë përgjithmonë.

Siç e ka sot njerëzia,
Kombi ynë që të shpëtojë,
Do shërbim nga bij' e bija,
Që me nxit të përparojë.

Vendi q'është në greminë,
Nga rreziku që të dalë,
Kërkon dritën, diturinë,
Nga çdo çupë e nga çdo djalë!

Një popull që s'i ka gratë
Me mësimë pak a shumë,
Ai popull është' i ngratë,
Dhe për jetë rri në gjumë.

Po të jesh ti e mësuar,
Çupë e vogël shqipëtare,
Shqipëria e mjeruar,
Bëhet shpejt përparimtare.

Prandaj, vashëz e uruar,
Që të zgjohemi në jetë,
Çap me nxit për të mësuar,
Të shkëlqejmë siç je vetë.

1921

SHIH, MË THE

— Shih, më the, zogjthit në qiell,
Sa liri ata gëzojnë,
Sa lirisht po fluturojnë,
Ç'po shijojnë er' e diell,
Rrojnë qetë në natyrë,
Për zili, sa s'ka më mirë.

S'ndryshon mashkulli nga femra,
Bredhin çifte të pandarë,
As m'i dyt' e as m'i parë,
S'mbajnë cmirë, asgjë në zemra,
Meshkuj, femra të kuptuar,
Jo krenarë të shfrenuar!

Shih ata sa dëfrenjë,
Dashurohen miturisht
Dhe jetojnë ëmbëlsisht,
Me shoshojnë po shkëmbejnë

Gaz e këngë, gaz e shpresë,
Dashuri me shpirt e besë!

Ndër ne, femra është' e ndrojtur,
S'bën asgjë pa një urdhratë,
Si «mëndshkurtër e leshgjatë»
Që ca meshkuj i kanë qojtur,
Femrazezat ca tiranë
I përpijnë kur faj s'kanë!

1921

B O R A

Copra dhe thrime bora mbi dhe,
Bije pa zhurmë, me lehtësi;
Vërtitet, kthehet lart përmbi re,
Gjersa rrëzohet mbi dhen'e zi,

Shtyhen, përshtyhen si flutrat n'erë,
Hapen, përleshën në hapësirë,
Herë çdo copë nxitet të bjerë,
Mbi dhe të sjellë një ftohtësirë.

Njerzit e varfër borën e quajnë,
«Vello nusrie», por «të tmerruar»,
Se kjo të mjerët i bën të vuajnë,
I mbyll rreth vatrës me zjarr të shuar.

Dheu kur zbardhet tepër me borë,
Zogjthit e vegjël gjith' po tmerrohen,
Një «ah» i thellë n'ata të gjorë,
Del, se për hejen ¹⁾ ata hutohen.

1) të ngrënë

Dhe çdo i varfër, çdo gjë e gjallë.
Kur shfaqet dimri, zë e mejtohet,
S'ka qysh t'i bëjë të ftohtit ballë,
Pa krejt nga jeta zë dëshpërohet.

As ka mëshirë për bagëtinë,
Bora e dendur që pushton dhenë,
Që iu fsheh hejen, iu shton urinë,
I bën në vojttje, humbur të venë.

Vetëm nga bota aspak s'na trembet
Kush është' i pasur me plot të mira,
Nuk na ndjen dimër dhe kush përkëmbet,
Se është' i ngrohtë me pasurira.

Nuk të ka frikë nga shi e borë,
Kush gjen mënyra se qysh të mbrohet;
Po keq dhe mjerë për aq' të gjorë,
Që vuajn' e ngrijnë kur dimri shtohet.

Shpeztë, fatkeqtë që ka kjo jetë,
Dridhen kur bora bie paprerë;
Po veç durojnë mbi dhen' e shkretë,
Se kanë shpresa për një pranverë.

L A R G I M I

Mos derdh lot margaritar,
Lule e re, moj dritë e ar,
Mbaji lotët me shtrëngim,
Që t'i derdhim për gëzim,
Në mojin veror,
Maj apo qershor,

N'atë ditë që ti pret,
Të na gjejë me shëndet;
Tek të jemi përsëri
Plot gëzim e dashuri,
Jetë e lumtëri,
Dhe për ne të dy.

1921

TE PUTHURAT

Ne e kemi një zakon,
Që shëndetin na dërmon:
Puthja me bot'e me mik,
Na hedh jetën në rrezik.
Kur takojmë një njeri,
Për t'i shfaqur dashuri,
Zëm'e puthim e na puth,
Na jep urth e thëthim urth.
Puthen duartë me djersë
Të sa plakave pa shpresë;
Puthen nuset e të ratë,
Puthen plakat e të vatë;
Puthen buzët karafite
Me të verdhat si kandile.
Kështu puthet e s'ndjen frikën,
Shëndetplota me oftikën.
Hyn sëmundja në shëndet
E na bën për lum'e det!

POPULL, POPULL, HAPI SYTË!

Është i «varfër» një «dervish» ¹⁾
Që jeton posi një mbret
Dhe fryhet raki e mish
E më mban plot salltanet?

«Dervish» nukë do të thotë
Të hash, të pish si një ka,
E të thuash më të kotë:
«Ejvalla»... dhe... «ejvalla!»

Me «ejvalla» dhe me «hu»
Nuk na thua «qeramet»,
Po mos rri si një kërcu,
Duke shfrytur «tuh lanet!»

Dreq, lanet na je ti vetë,
Që bën aqë poshtërsi,
Që lidh botën porsiqetë,
Dhe i rjep me djallëzi.

Eh, si mjerë kush nderon
Një dervish, një gomar hor,
Që si djalli të lajkon
Edhe mbahet si «shenjtor».

Dervish bëhet një përtac
Që s'do kurrë të punojë,
Se ç'i duhet një kërbac,
Trupnë e trashur t'ja hollojë!

Popull, popull, hapi sytë,
Mos ushqe ujkun me fe:
Rroki librat e merr dritë
Të njohsh derrat në teqe!

1923

1) Fjala «dervish» rrjedh nga persishtja dhe do të thotë «i varfër».

PËRMENDU, SHQIPTAR!

O ti shqipëtar i mjerë,
Po të pyes, si kurdoherë,
Se përse rri kaq'i mpirë,
Dhe s'punon të rrosh i lirë.
Nuk shikon se ke një zgjedhë,
S'shikon varrin kaq të thellë,
Që të hapet or'e ditë,
Për të mbetur pa një dritë,
Pa fole, pa nder në botë,
Me një rrojtje krejt të kotë?
Kur harrove historinë,
Që përshkruan trimërinë,
Trimërin'e gjyshvet tanë,
Q'aqë nam mbi dhe na lanë?
Kur harrove që një moti,
Ishte gjallë Kastrioti,
Ai prijsi trim në Krujë,
Që gjith' kombit i dha bujë,
I dha bujë se luftoi,
Në aq luftra triumfoi?

Aleksandr'i Madh, i fortë,
Q'e kish tundur këtë botë,
Si dhe toskë Pirro-Burri,
Me një zemër si prej guri?
S'të kujtohen nopak tynë,
Të përmendesh për Shqiprinë?
Shkunde zemrën edhe trupin,
Mos e ha me bukë turpin,
Jepi botës të kuptojë
Se Shqipria do të rrojë!
Nuk u thave, or' i gJORë,
Nga ky dimr' e nga kjo borë.
Nga kaq halle e mjerime,
Nga kaq turpe e çnderime,
Që si breshër po të vijnë,
Jetën tënde të ta nxijnë? . . .
Shih ç'po bën kurva Evropë,
Rrëmon të hapij një gropë,
Ty dhe mua të varrosë,
Kombin tonë ta çfarosë!
Shih, pra, shih dhe për rreth fqinjtë,
Presin kohën si arinjtë,
Rreth kufirit po përdridhen,
Përmbi ne ata të hidhen,
Të na hidhen si më parë,
Të na shuajn' komb e farë!
Rreth-përçark ke ligësitë,
Edhe brenda djallëzitetë,

Që të shtyjnë pa mëshirë,
Të të hedhin n'errësirë. . .
Tani, cilën pëlqen tinë,
Zhdukjen tënde, a lirinë?
Në do lirinë të kemi,
Duhet mbledhur gjithë sa jemi,
Duhet mbledhur e betuar,
Për lirin'e shenjtëruar,
Se me luftë e besa-besë,
Me guxim, vullnet e shpresë,
Ësht e sigurt që Shqipria
Do të rrojë sa gjithësia!

1923

JEMI NJË KOMB HEROIK

Jemi një komb heroik,
Bijt'e trimave të parë,
E dërmuam robërinë,
Edhe shkelësit barbarë. . .

Ku ka parë historia,
Si ne, trima e të zotë,
Që luftojmë e triumfojmë,
Sa çuditet gjith kjo botë?

Me kë vallë nuk luftuam,
Dhe kur mbetëmë të sharë?
Ndriti emr'i Skënderbeut,
Nga stërniprit shqipëtarë.

Për guximin e shqiptarit,
Për kët' popull në pakicë,
Dëshmon Butka, Qaf'e Qarrit,
Si dhe Gryka në Skërficë.

Dëshmon Vlora e Sazani,
Hovin tonë të paprerë,

Flasin malet, brigjet, kodrat,
Që na shihnin kurdoherë.

Dëshmon bota, dëshmon deti.
Përrua, lum'e çdo kënetë,
Se qysh armët shkrepëtinin,
Si Skënderi kur ish vetë.

Pa dëshmon dhe shum'e shumë,
Gryk'e keqe, Kaçaniku,
N'atë vend e në Kosovë,
Qysh u thye turk armiku.

Luftuam me italianët;
I thyem e i larguam,
Pa dhe me sërb'e junanët,
Mbrojtmë nderin, u lartuam.

Edhe pse jemi pakicë,
Kur të kemi sedrë e besë,
S'ka të metë as pakica,
Se luftojmë një me pesë!

Duam të lirë të rrojmë!
Pra, të ndjekim djallëzitë
Dhe me nxit të përparojmë,
Të shkëlqejmë porsi dritë!

IRONIA BOTORE

Idealistit

Kur gjithë botën ti e deshe,
Bota e vjetër ty s'të deshi,
E kudo ti kur nënqeshe,
Ajo u tall, të përqeshi.

Ty, kur shok ke idealë
Dhe punon me plot dëshirë,
Të pengojnë ca brutalë,
Që gjak njerzish kanë pirë.

Me dyzina plot bujarë
Janë qojtur «trathëtorë»,
Por, si vdiqnë a janë vrarë,
Na u qanë si therorë.

Te kjo botë shumë hajdutë
Gjejnë raste përfitimi,
Grushte hanë aqë t'urtë
Dhe një rrojtje mallëkimi.

Çdo i ndershëm e i drejtë
Sa është' gjallë as peshohet,
Po pas vdekjes, von'a shpejt,
Vepr'e tij fillon të çmohet.

1925

PËRBUZJET

Kur të shan ndonjë zagar,
Faqeza a në mungesë,
Mos u prek, pra, o bujar,
Se leh një qen i pabesë.

Sepse shan një hipokrit,
Pse leh kot një qen pa dhëmbë,
Mos u nxit e u mërzit,
Mos i mat as shkop, as këmbë.

Qeni leh, karvani shkon,
As dhe syrin nuk ja kthen,
Qeni lehës s'të kafshon,
Dhe asgjë prej tij s'të gjen.

Një pa vleft' a një hajvan,
Kur të shan, pra, të nderon;
Ai si çdo sharllatan,
Me përbuzjet të larton.

Pse ti paske ideal,
As mos prit një përhirim,
Se s'përfill asnjë brutal
Ideal a njerëzim!

Pse ti paske dhëmshuri,
Si për bot'e për Atdhe,
Ku të çmohet, a derëzi,
Nga ca ujqër të pafre!

Mbi një pemë hidhet gur,
Mbi një degë që ka frytë,
Kurrë jo mbi plep a mur,
Po mbi frytin që nxin sytë.

Të mos ishte ky nakar,
Nuk dallohej njerëzia
Kush zuzar e kush bujar,
Si nga shpirti e nga vetija.

Nuk njolloset diamanti
Prej një shtaze intrigant,
Diamanti a brilanti,
Mbetet gjithnjë diamant.

1925

PUNA DHE PËRTIMI

Cinxëri në verë,
Ja thot'e këndon,
Për tjetër në botë,
Fare nuk mejton.

Kur në verë prehet,
Përtacja gjinkallë,
Në dimër uriet,
Ngordh e shkon në djall.

Ky është një shembëll,
Këshill'e mësim,
Që fund' i përtimit,
Ësht' edhe pësim.

Kush punon, në botë,
Rron e përfiton,
Dhe kush bën përtime,
Nga skamja lëngon.

BIJVE TË MI

Bijt'e mi, nëse më doni,
Këto fjalë m'i pranoni;
Ma dëgjoni një këshillë,
Bot'e urtë t'ju përfillë!
Them: përpiqi, mbani nderë,
Mos e humbni asnjëherë.
Mos u bëni lajkatarë,
Veç seriozë e të mbarë.
Prehja, gazi e dëfrimi,
Mirërrojtja a mjerimi,
Malli, gjëri, pasuria,
Kot lavdia, madhështia,
Në çdo duar ven'e vinë
Përfundojnë në greminë!
Por brilanti më me vlerë
Është kur di të mbash nderë!

PËR BAJO TOPULLIN

(Elegji)

Kambanat po bijen, salla po thërret:
— Mblidhi, gjunjëzohi, popull, o rrëmet!
Një luan i shqipes dha shpirt, fluturoi,
Qasi ta nderojmë, siç ky na nderoi!...

Qasi ta vajtojmë, vajto Shqipëri!
Numëroni, flisni për veprat e tij,
Veprat e kti burri që është sot pa shpirt,
Shpirt i lart'i kthjelltë, shpirt që mbi ne ndrit! —

Më çdo anë heshtje, asnjë s'pipëtin,
Çdo send ka pushuar, veçse një vajtim,
Veçse lum'e prrua thërret e buçet:
— Vdiq, pra, vdiq luani, vajto, o rrëmet!

Vajto ti, o popull, vajto ti, Atdhe!
Vajto, Gjirokastër mbuluar plot re
Vajto veteranin, që dha shpirt e shkoi,
Shpirt që ty përjetë emrin ta lartoi !..

1930

KUSHTRIM KOMBËTAR

Gjelbëro, o bar i njomë i beharit,
Gjelbëro dhe jepi frymë shqipëtarit,
Jepi frym'e ndizja zemrën të lëvizë,
Për t'i dhënë frym'e jetë Shqipërisë.
Ndizja zemrën të qërojë gjëmb e ferrë,
Ndizja zemrën të shpagohet nga ca krerë,
Nga ca bisha, trathëtarë pa mëshirë,
Që na hodhnë te kjo gjendje e vështirë!
U përçmua Shqipëria, shkoi e vate,
Shkoi e vate se u lidhmë me traktate,
Me traktate për t'u ngjallur ca sulltanë,
Ç'hodhnë kombin në mjerim e pus-hapsanë.
Me traktate, për pallate plot mëkate,
Njoll' e turpit po na nxin qysh kësaj date,
Me traktate!... me vargonj e me litarë,
Kurrë, kurrë frym'e jetë të mos marrë.
Tradhëtisht na kërcënohet robëria,
Tradhëtisht po gllabërohet Shqipëria;
Tradhëtisht ky vend i gjorë shqetësohet,
Po grabitet, vdes uriet, poshtërohet!

Ah !... dhe zogjthit që këndonin, sot po qajnë,
 Në vend t'këngës, kësaj vere, zi po mbajnë.
 Këngë zie po dëgjohet anembanë,
 Tmerr i vdekjes tingëllon si një kambanë !...
 Ah, ballkanas që e gjeçi gjith' belanë,
 S'u përlidhtë si ballkanas për Ballkanë,
 Konkuronit që Shqipërinë ta coptonit,
 Kurse duhej ta forconit e ta mbronit!
 Ja, pra, fundi, qysh ngatrruat veten tuaj,
 Ja si shtrohet mbi Ballkanin çizm'e huaj,
 Ja fashizmi, porsi djall na hyn në derë,
 Për të kthyer gjith Ballkanin në skëterrë!
 S'e duruat Shqipërisë t'ishte zonjë,
 Shihni tash si ju shqetsojti kjo shqiponjë:
 Ra, vërtet, në lak Shqipria, por Ballkanë,
 E mallkon me duf të rëndë, e heq branë !...
 Vendi ynë që na ishte vend viganësh,
 Çerdhe trimash, luftëtarësh e luanësh,
 Sot po duket si një varr në shkretëtirë,
 Me të vdekur që lëvizin krejt të mpirë;
 Nderi, sedra kanë marrë tatëpjetën,
 Kurrëria po sundon mbi të vërtetën...
 Sos u shtrydhe, o ndërgjegje kombëtare!
 Sos u ndryshke, shpat'e mprehtë shqipëtare!
 Sos ish fjalë trimëria stërgjyshore,
 A legjendë ato luftra shëmbëllore;
 A ne s'ishim ata trima madhështorë,
 Q'u vërsulmë dhe shpëtuam trimen Vlorë;

Q'u përshkruam prej fill ari n'istorinë,
Sa, gjith' bota e pat shembëll Shqipërinë?
Sos, pra, s'jemi nip-stërnipër t'Kastriotit,
Sos, pra, jemi të përflakur sot prej motit,
Q'i durojmë të këqiat duarlidhur,
Q'e gëlltitim këto turpe kaq të hidhur?...
Lëvri, gjak i shqipëtarit dhe një herë!
Tundu vendit, rrok dhe armët këtë verë,
Ngre, pra, krye, trego veten si më parë,
Shkunde trupnë nga kjo njollë e pangjarë;
Trego shenjë gjallërie, burrërie,
Skuqë tokën për një frymë prej lirie:
Ja përmbysë tiranin'e tradhëtinë,
Ja përmbysu të kënaqësh vetëdinë,
Se kjo rrojtje kaq e ndyrë e plot mynxyrë,
S'të ka hije, po marsho me çdo mënyrë!
Dridhu tiranin, o dridhu nër pallate,
Vjen pra ora t'i shpërblesh ti kaq mëkate,
Se Shqipria s'ka shteruar nga luanë,
Shpejt do zhduken tradhëtorë dhe tiranë!

maj 1928

KËNGE VAJI

Kushtuar heroinës së romanit

«Sikur të isha djalë»

të H. Stërmillit.

Të martoi yt atë ku na deshi vetë,
S'të pyeti fare, o vashëz' e shkretë!
Ishe një thëllëzë, zogë gjeraqinë,
Po s'kishe dhe fatin siç ishe dhe tinë.
Ti kur ishe flutur, ujkun të dha burrë
S'të qeshi, e gjorë, buz' e bukur kurrë.
Ta shkëputnë zemrën nga zemra dashnore
T'u venit fytyra e buza gazmore,
Duvakun që t'ishte cip e nusërisë,
Mjerë, seç ta bënë qefinin e zisë!....
Po të qanë dashnori pa prerë e pa reshtur,
Ta vadit me lotët varrin tënd të heshtur.
Ata lot vesojnë kopshtin trandafila,
Ku ja thon' përvajshim të ngratët bilbila....
Dil, moj hën' e bukur, ylli Afërditë,
Hape varr'e shkretë, shkrep andej një dritë;

Ti s'vdiqe vetiu, o vashë viktimë,
Therore zakonesh me kaq pikëllime,
Të tërhoqi mortja pa të ardhur dita,
U fishke si lule, u fike si drita. . . .
Zogjthit s'po pushojnë, mbi varr të vajtojnë,
Gjithë këngë vaji për ty ligjërojnë.
Humbi bukuria në ver'e në lule,
Se ishe m'e bukra lule q'u përkule.
E shkretove vendin, helmve aq zemra;
Të vajton rinia, meshkuj edhe femra:
—Mjer'o mjerë! — thanë shoqet kur të qanë,
Nëmën e mallkuar zakonit i dhanë!.....

1936

HANKO NUSJA

Përgjegjje «Hanko Hallës» së A. Asllanit

Na qenka, na thënka një Hallë ca fjalë,
Kritika për nuse, kritika për djalë.
Foli nga zakonet, të tashm'e të parat,
Numëroi të ngjarat edhe të pangjarat;
Hanko Halla foli, prashiti sa mundi,
Sa gjë më s'i mbeti, ç'kish në trast' i shkundi;
Halla, Hall'e mprehtë e Ali Asllanit,
Ligjëroi për nusen, vajzën e zamanit.

Hanko Halla rokë ¹⁾ llomotit e thotë:
«Medet se ç'na gjeti, ç'po priset kjo botë;
Pse nuset e sotme s'thonë lepe-peqe,
S'thonë lepe-peqe, por të ngrehin leqe. . .»
Si do vallë Halla, a mos nus'e shkretë;
Duhet të gëlltitij çdo mjerim në jetë?
Të ngrihet me natë, të fshij'e të lajë,
Pa lejën e Hallës bukë të mos hajë?

1) rokë — rrozgë, plakë e rënë

Nuse sa për faqe, por në fakt kopile, 1)
Në fakt një kopile, si mushka me zile. . .

Hanko Halla jonë, a Halla vlonjate,
Për nusen e djalit vjehërr shpirtlugate,
Na e dashka nusen këmbët të i shtypij,
Këmbët të i shtypij sa që të dremitij,
Dhe as mos t'i thotë: «Shko, se të pret burri!»
Burri lum'e prrua që ka rën' qëkuri,
Dhe po pret të renë së bashku të flenë,
Siç flinte një kohë Halla pikërenë
Iu ngushtua zëmra asaj Hallës shtrigë,
E prandaj, pra, nusen e ka gjëmb në grykë!

Hallës së krijuar nga zjarr'i xhehnemit,
S'i pëlqeka nusja të jet'e kalemit;
Na e dashka nusen për furr'e kulaçe,
Pa ç'ka pse të jetë një gdhë a kopaçe,
Ç'ka sepse të jetë një krijes'e fatit,
Mjafton që të jetë nus'e itaatit,
Për Hallën më mirë — një nuse leshgjatë,
Sesa një leshprerë me mendje të artë.
Leshprer'a leshgjatë, sido që të jetë,
Natyren ta ketë siç do Halla vetë. . .

1) kopile — këtu: shërbëtore

Ka ca vjet që Halla, Halla kadënxhikë,
Ja përflet përhera nuses pajë prikë:
Pse nusja s'ka sjellë një pajë të sosur,
As jelek t'ergjëntë, as gozhuk të qosur,
As dhe vogëlina për foshnjën që lindi,
E nga kjo pra Hallës i ka hypur xhindi.
Grindjet e thethashat s'kanë të pushuar,
Një bela për nusen kjo Hall'e harbuar!
Pa del e të thotë Halla mendjelënë
Se s'e paska nusen, nuse për të qënë;
E hëngri me gridhmë, eh, të ren'e shkretë,
Sikur Halla pajën do ta veshij vetë...

Nusja do të dalë, Halla s'i jep lejë,
Në prindër a gjetkë s'e lejon të vejë,
E mbyll nëpër dhoma të laj'e të fshijë,
Pa edhe sëmundja fillon ta përfshijë.
Diell s'të sheh kurrë, erë s'merr aspakë,
E reja e shkretë, kurbane për plakë,
Fishket edhe fiket si lulja pa ujë.
Kështu vatr'e lumtur kthehet në rrëmujë,
Nusja e ndes zjarrë, po në zjarr s'të ngrohet;
Nusja fle më vonë, por më shpejt të zgjohet.
Dhe në mos u zgjoftë, e zgjojnë të tjerë,
Gjuhë e mprehtë e Hallës — gati për poterë;
E pse kaq mjerime? ... Se ashtu do plaka...
Me ferman të plakës në qiell shkon flaka!

Hanko Halla nusen s'na e do të flasë,
Dhe sikur ta fyej, a kur t'i bërtasë,
Nusja gëk mos bëjë dhe pa faj të jetë,
Pa më pas të drejtën e gjen Halla vetë
E gjen Halla vetë por... «më fal» s'i thotë,
Edhe përse nusja u sha më të kotë:
Nusja është nuse, duhet sus të rrijë,
Çdo fyerje a sharje heshtazi ta pijë!...

Sipas Hanko Hallës, një nuse me burrë
Para' saj mos lozë, as të qeshë kurrë,
Emrin e të shoqit nusja mos e thotë,
Se porsa e thënka, s'ka më turp në botë!...
Po Halla s'kujtohet se burri me grua,
Siç e di dhe vetë, janë mish e thua,
Siç e di dhe vetë, se... dreqi e solli,
Me burrin që s'lostë... ndo... dhjetë na polli...

Halla na pandehka se u prishka jeta,
Sepse po na dalka në shesh e vërteta,
Shkon vapa me gushtin, shkon dhe koh'e parë,
S'duhet mbajtur nusët lidhur me litarë;
Dolli e vërteta, dhe pse plot të meta:
Nusja do shpëtojë si peshku nga rrjeta...

1936

PIJANIKU

Kur fëmija në shtëpi,
S'ka të ngjyey as shëllirë,
Burri shtrohet në raki,
Mbytet, dehet në të pirë.

Boll mezeja, boll rakia. . .
E pandeh se gjen dëfrim,
Pa çdo hajë dhe fëmija,
S'do t'ja dijë aspak ky trim. .

Pi çdo drekë e pi çdo darkë,
Në mëngjes po kur gjen pi,
Sa e shkund të shkretën arkë,
Sa prish zorr'e mushkëri.

Shet çdo send që ka në jetë,
Mbetet keq e tambura,
E marron e pir'e shkretë,
Ngel mbi dhe si një zurna.

Po dhe prapë nuk heq dorë,
S'e përfill këtë mëkat,
Prapë s'ndjen se është i gjorë,
I shkëlqen pandeh ky fat.

Gruazeza ç'u gënjye,
Mori burrë një sarhosh,
Me sarhoshin u përlye,
ju nxi jeta, ju bë trosh.

Ç'hall të gjeti, moj e ngratë,
Që po fike në trishtim,
Nga lëngimi e barku thatë,
E nga grindjet pa pushim!

Mjerë ç'dert që të ka zënë,
Kur sarhoshin e ke shoq,
Atë mendja e ka lënë,
Po dhe shiptri ty t'u dogj

1940

KRENARI MËNDJELEHTË

Si kalliri q'është'i lehtë,
Që gjithmonë bën përpjet,
Që s'ka kokrra ta rëndojnë,
Apo sende ta pengojnë,
Kështu, pra, dhe mendjelehti,
Mbahet lartë në vetveti.
Dhe kur shkon a kur qëndron,
Dhe kur flet a kuvendon,
Kryet krejt e mban përpjetë,
Si kalliri kasht'a fletë;
Është kot e pa një vlerë,
Pra, rri lart e si mbi erë.
S'ka pak tru që ta rëndojnë,
Kryet unjur t'ja qëndrojnë
Është'i lehtë nga fiqiri,
Pra, rri lart posi kalliri.

1941

HASAN XHIKUT

Kush të sheh, s'beson askurrë,
Ti të ishe një trim burrë;
S'e pandeh askush në jetë,
Të kesh qenë trim me fletë.

Si të shohin pleqërinë,
S'ta besojnë trimërinë,
S'dinë q'ishe trim i rrallë,
Luftëtar, petrit i gjallë.

Ku ja bënte bam dyfeku,
Ku tronditej mali, bregu,
Atje ishe edhe tinë,
Ku luftoje për lirinë.

Edhe vitet në harrojnë,
Janë malet që dëshmojnë,
Nuk harron, pra, historia,
Çfarë trim të kish Shqipria.

Gjirokastra, ku ke lerë,
Të ka bir dhe bir me vlerë,
Siç ka Çeçua shtatujë,
Ke dhe ti një nam e bujë.

Përshëndetje, Hasan Xhiku, 1)
Zemërstrall e shpirtçeliku!
Emri yt për ne i gjallë,
Do të mbesë, o trim me pallë!

Dhjetor 1944

1) Luftëtar dhe patriot i Rilindjes dhe i Luftës nacionalçlirimtare.

BINISË

Syri ynë, shpirt, Rini,
Është kthyer sot tek ti,
Nga ti pret Atdheu zhvillim,
Punë krahu, vrull, guxim;
Para-marsh, si sot, për mot,
Jetës, dritës dili zot.
Sot çdo prind dhe kush dëshmon,
Këngë e lavde të kushton!

Ji plot gaz, popull shqiptar!
I përvojtur, po krenar,
Ji plot gaz se kjo Rini,
Vasha e djem plot gjallëri,
Që kalit nëna Parti,
Si në luftë dhe tani,
T'është ngritur me bajrak,
Po derdh djersë e tru e gjak,
Dhe punon në çdo drejtim,
Për një t'arthme plot shkëlqim.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Parathënje	5
Sa të dua	13
Në udhë të mërgimit	14
Tmerri i Hormovës	15
Behari dhe zemra ime	17
Shqipërisë	19
Mërgimi	21
Ndëjesat	23
Druvari plak dhe vdekja	25
Për Themistokli Gërmenjin	27
Shkolla «Drita» e Gjirokastrës	29
Qime e bardhë	31
Gjirokastra.	33
Lufta e labëve në grykën e Skërficës	35
Jeta ime në Amerikë	38
Lamtumirë, Amerikë.	40
Vaporit «Patria».	41
Trumbeta e Bashkimit	43
Luftë për liri	45
Të lumtë, o gjahtar i kombit!	47
Vlorës.	49
Për Selam Musa Salarinë	51
Shqipëri, o mëma jonë!	53
Pendës.	55
Çupës shqipëtare.	56
Shih, më the	58
Bora.	60